



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 127

Tiranë – E martë, 21 korrik 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 17, datë 3.6.2015	Për kryerjen e procedurës së prokurimit të përqendruar “Shërbim interneti në sistemin arsimor parauniversitar për vitin 2015”..... 6659
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 18, datë 12.6.2015	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 11/1, datë 15.04.2015 “Për botimin e teksteve shkollore të reja për vitin shkollor 2015-2016”..... 6659
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 19, datë 12.6.2015	Për porositjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore për klasat II-V dhe VII-XII për vitin shkollor 2015-2016..... 6660
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 20, datë 16.6.2015	Për shpalljen e konkurrimit për tekstet shkollore digjitale për vitin shkollor 2015-2016..... 6661
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 21, datë 26.6.2015	Për vlerësimin e çmimeve të teksteve të reja dhe çmimeve të teksteve digjitale, në sistemin e arsimit parauniversitar..... 6663
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 21, datë 9.7.2015	Për procedurat e transferimit të nxënësve nga një nivel/drejtim i arsimit profesional në gjimnaz..... 6664

**UDHËZIM****Nr. 17, datë 3.6.2015**

**PËR KRYERJEN E PROCEDURËS SË
PROKURIMIT TË PËRQËNDRUAR
“SHËRBBIM INTERNETI NË
SISTEMIN ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR
PËR VITIN 2015”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 11, pika 1/b e ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të nenit 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ligjit nr. 160/2014 “Për buxhetin e vitit 2015”, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”,

UDHËZOJ:

1. Realizimin e procedurave të prokurimit për furnizimin me shërbimin e internetit për sistemin arsimor parauniversitar publik, me procedurën “Prokurim i përqendruar”, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

2. Ministria e Arsimit dhe Sportit merr përsipër rolin e organit qendror blerës për zhvillimin e procedurës së prokurimit në emër dhe për llogari të njëjësive arsimore vendore (drejtorive arsimore rajonale/zyrave arsimore) për shërbimin e internetit.

3. Të dhënat teknike/sasiore dhe fondi përkatës për kryerjen e këtij shërbimi përcaktohen dhe dërgohen të miratuara nga MAS, në formë të shkruar dhe elektronike (CD, *e-mail*), sipas informacionit të marrë nga çdo DAR/ZA.

4. Ministria e Arsimit dhe Sportit është përgjegjëse për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit, duke filluar nga njoftimi i kontratës deri në shpalljen e njoftimit të fituesit.

5. Pas njoftimit të fituesit, Ministria e Arsimit dhe Sportit dërgon në çdo DAR/ZA dokumentacionin e plotë, në formë të shkruar dhe elektronike (CD), për të vijuar me nënshkrimin e kontratave përkatëse prej tyre.

6. DAR/ZA, brenda 5 ditëve pas nënshkrimit të kontratës, duhet të dërgojnë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit njoftimin e kontratës së nënshkruar në formë të shkruar dhe elektronike

(CD), i cili do të do të hidhet në sistem elektronik nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

7. DAR/ZA-të janë përgjegjëse për ndjekjen e realizimit të kontratës.

8. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Financës, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit e Komunikimit dhe drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE I SPORTIT
Lindita Nikolla

UDHËZIM**Nr. 18, datë 12.6.2015**

**PËR DISA NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN NR. 11/1, DATË 15.4.2015
“PËR BOTIMIN E TEKSTEVE
SHKOLLORE TË REJA PËR VITIN
SHKOLLOR 2015-2016”**

Në mbështetje të neneve 45 dhe 47 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010 “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 11/1, datë 15.4.2015 “Për botimin e teksteve shkollore të reja për vitin shkollor 2015-2016”, të ndryshuar, afatet kohore të zhvillimit të konkursit, të parashikuara në pikën I, të ndryshojnë si më poshtë:

“I.3 AFATET KOHORE TË ZHVILLIMIT TË KONKURSIT

Shpallja e konkurrimit: 20 prill 2015;

Dorëzimi i teksteve shkollore: 1 korrik 2015;

Shpallja e fituesve: 15 korrik 2015;

Përzgjedhja nga mësuesit:

31 korrik -7 gusht 2015;

Shpërndarja dhe shitja e teksteve:

1 shtator -13 shtator 2015. ”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar dhe Komisioni i Vlerësimit të Teksteve në MAS.



Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE I SPORTIT
Lindita Nikolla

UDHËZIM
Nr. 19, datë 12.6.2015

**PËR POROSITJEN, SHPËRNDARJEN
DHE SHITJEN E TEKSTEVE
SHKOLLORE PËR KLASAT II-V DHE
VII-XII PËR VITIN SHKOLLOR 2015-2016**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 47 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010 “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

**I. POROSITJA E TEKSTEVE PËR
VITIN SHKOLLOR 2015-2016**

1. Për vitin shkollor 2015-2016, katalogu i teksteve shkollore për klasat II-V dhe VII-XII, bashkëlidhur këtij udhëzimi, të përbëhet nga teksteve shkollore më cilësore të përzgjedhura nga mbi 10% e të gjithë mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

2. Porositja e teksteve të bëhet mbi bazën e përzgjedhjes së realizuar sipas udhëzimit të ministrit të MAS nr. 9, datë 26.3.2015 “Për përzgjedhjen e teksteve shkollore më cilësore për vitin shkollor 2015-2016”.

3. Shkollat që kanë përzgjedhur teksteve shkollore që nuk janë pjesë e katalogut bashkëlidhur këtij udhëzimi, të ripërzgjedhin, në bazë shkollë, teksteve shkollore nga ky katalog, sipas udhëzimit të ministrit të MAS nr. 9, datë 26.3.2015 “Për përzgjedhjen e teksteve shkollore më cilësore për vitin shkollor 2015-2016”.

4. Drejtori i shkollës, brenda datës 17 qershor 2015, të porosisë teksteve zyrtarisht në çdo shtëpi botuese/distributor, duke përcjellë një kopje origjinale të tabelës përmbledhëse me titujt dhe sasinë e teksteve shkollore.

5. Drejtori i shkollës të dërgojë në DAR/ZA, brenda datës 22 qershor 2015, tabelën përmbledhëse me titujt dhe sasinë e teksteve të porositura nga shkolla.

6. Drejtorët e shkollave të pakicave kombëtare dhe të arsimit profesional t'i dërgojnë shtëpisë botuese BOTEM, brenda datës 17 qershor 2015, porosinë e tyre për teksteve shkollore me një alternativë, ku të shënojnë saktësisht numrin e nxënësve të tyre.

7. Dokumentacioni që rrjedh nga zbatimi i këtij udhëzimi, të ruhet në arkivin e shkollës për dy vjet dhe të jetë objekt i kontrollit të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit dhe të MAS-it.

**II. SHPËRNDARJA DHE SHITJA E
TEKSTEVE SHKOLLORE**

1. Botuesit /distributorët janë përgjegjës për shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore.

2. Shitja e teksteve shkollore të bëhet nga njësitë tregtare të shitjes së librave. Çdo shkollë, për periudhën 25 gusht -13 shtator 2015, u vë në dispozicion falas personave të ngarkuar nga shpërndarësit e rrethit (librashitësit), një ose dy klasa të sigurta për shitjen e teksteve shkollore me hologramën e MAS-it.

3. Ndalohet shpërndarja dhe shitja e teksteve shkollore nga punonjës arsimorë, me përjashtim të shkollave të arsimit profesional dhe të pakicave kombëtare, ku shpërndarja dhe shitja e tekstit shkollor mund të bëhet nga punonjës arsimorë të ngarkuar nga DAR/ZA-ja dhe nga drejtoritë e këtyre shkollave.

4. Përgjegjësi i sektorit të kurrikulës në DAR /përgjegjësi i sektorit të kualifikimit dhe cilësisë në ZA është personi përgjegjës (pikë kontakti), që mban lidhje të vazhdueshme me MAS-in dhe informon për mbarëvajtjen e procesit.

5. Subjekteve të licencuara për shitjen e teksteve shkollore nuk u lejohe të shesin në shkollë libra që nuk u përkasin katalogut të teksteve shkollore bashkëlidhur.

6. DAR/ZA-te, gjatë dy javëve para fillimit të vitit të ri shkollor dhe një javë pas tij, të raportojnë në MAS çdo ditë, në mënyrë të vazhdueshme, për pajisjen e nxënësve me teksteve shkollore.

7. ISHA, pas monitorimit të procesit të shpërndarjes dhe të shitjes së teksteve shkollore, t'i raportojë me shkrim ministrit të Arsimit dhe Sportit.



III. ZBATIMI DHE HYRJA NË FUQI

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, drejtoritë arsimore rajonale, zyrat arsimore, shkollat dhe mësuesit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE I SPORTIT
Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 20, datë 16.6.2015

PËR SHPALLJEN E KONKURRIMIT PËR TEKSTET SHKOLLORE DIGJITALE PËR VITIN SHKOLLOR 2015-2016

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

I. KËRKESA PËR TEKSTE SHKOLLORE DIGJITALE

Për pajisjen e nxënësve të klasës X me tekste shkollor digjitale (të sistemeve mësimore interaktive) në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar që kanë laboratorë me tableta për integrimin e platformës *e-learning*, për vitin shkollor 2015-2016, të shpallet konkurrimi sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

II. PROCESI I PARAQITJES SË TEKSTEVE SHKOLLORE DIGJITALE

1. Datat e aktiviteteve:

Shpallja e konkurrit: 17 qershor 2015;
Dorëzimi i teksteve shkollor digjitale:

2 korrik 2015;

Shpallja e fituesve: 12 korrik 2015.

2. Pjesëmarrja në konkurrim:

a) Shtëpitë botuese/distributorët, vendas apo të huaj, apo subjekte të tjera të interesuara, kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurrimin për tekstet shkollor digjitale (sisteme mësimore interaktive) në përputhje me këtë udhëzim, nëse e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shtëpitë botuese/distributorët, që kanë shkëlur kushtet e kontratës të

viteve paraardhëse, të nënshkruar midis tyre dhe MASH/MAS, nuk pranohen të marrin pjesë në konkurrim.

3. Përgatitja e teksteve shkollor digjitale:

Përgatitja e teksteve shkollor digjitale (sistemeve mësimore interaktive), të bëhet në përputhje me programet mësimore të miratuara.

Çdo sistem interaktiv online, që do të paraqitet në konkurrim, të plotësojë kriteret profesionale të mëposhtme:

1. Të integrojë katër funksionet bazë “Mësimdhënie”, “Nxënie”, “Administrim qendror”, “komunikim online nxënës-mësues-prind Administratë arsimore”.

2. Të mundësojë mësimdhënien dhe nxënien interaktive të shkencave ekzakste, lëndëve shoqërore dhe gjuhëve të huaja, që zhvillohen në 60 shkollat pilot.

3. Të ketë fleksibilitet për çdo format përdorimi në grup ose individualisht.

4. Të mundësojë komunikim online me prindërit e nxënësve, sensibilizim dhe mundësi reale të mësimin, në kuadrin e shkollës komunitare.

5. Të jetë i thjeshtë në përdorim.

6. Të funksionojnë 100% të gjitha elementet e sistemit interaktiv online në tabletat digjitale me të cilat janë pajisur 60 shkollat pilot.

7. Të jenë në dispozicion të përdoruesve përkatës për mësim, mbikëqyrje dhe supervizion 24 orë/24 orë, pa ndërprerje, gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së aplikimit të sistemit, të gjitha strukturat dhe përmbajtja e sistemit interaktiv online.

8. Sistemi interaktiv të mundësojë:

a) Përdorimin nga nxënësi të moduleve të klasës X, me qëllim që nxënësi të mund të përsërisë në çdo kohë lëndën që u takon klasave të mëparshme dhe të avancojë në klasat më të larta, nëse dëshiron.

b) Përdorimin nga nxënësi të çdo materiali mësimor shtesë në format digjital, që i dërgon online mësuesi i lëndës.

c) Asistencë automatike për nxënësin (kontroll, verifikim, korigjim).

d) Integrimin online të çdo përditësimi teknik dhe përmbajtësor, pa penguar ecurinë funksionale të përdorimit.

e) Bilanc automatik të përditësuar për vlerësimin vetjak të punës së kryer nga nxënësi në modulën (nivele) përkatës.



f) Postë personale mësues-nxënës, për secilin mësues dhe secilin nxënës.

g) Kontroll online nga ana e mësuesit dhe vlerësim objektiv të punës së kryer nga secili nxënës.

h) Grupim të nxënësve sipas klasave/lëndëve.

i) Komunikim me e-mail të mësuesit me nxënësin dhe prindin.

j) Bibliotekë me përmbajtje digjitale standarde (ushtrime, programe të plota etj.) në shërbim të mësuesit.

k) Hartimin nga mësuesi të programeve *ad-hoc* II me elemente të gatshme standarde dhe me materiale nga burime të tjera digjitale (internet ose burime personale) dhe dërgimin nxënësit / nxënësve online.

l) Drejtimin nga i njëjti mësues i klasave virtuale, homogjene dhe mikse.

9. Në rastin e sistemeve mësimore interaktive të gjuhëve të huaja, të mundësohet zhvillimi dhe ushtrimi interaktiv i katër aftësive bazë për komunikim gjuhësor (dëgjoj, lexoj, flas, shkruaj).

10. Sistemi interaktiv të shoqërohet me:

a) Tekste bazë (pjesa e printueshme) për lëndën ose lëndët që ofron sistemi, në format të printuar dhe PDF, për t'i pajisur nxënësit (sipas kërkesës) për të gjitha nivelet përkatëse.

b) Udhëzues përdorimi për nxënësin, në format të printuar dhe PDF (sipas kërkesës).

c) Dokumentet dhe procedurat për trajnimin e mësuesve që do të punojnë me këtë sistem.

III. FUTJA E TEKSTEVE TË MIRATUARA NË KATALOGUN E TEKSTEVE SHKOLLORE DIGJITALE (SISTEMEVE MËSIMORE INTERAKTIVE)

a) Ministri ngre komisionet e vlerësimit të teksteve digjitale (KVTD), për shkencat ekzakte, lëndët shoqërore dhe gjuhët e huaja të klasës së 10-të.

b) Komisionet të shqyrtojnë çdo tekst digjital të paraqitur nga konkurruesit.

c) Subjektet konkurruese të demonstrojnë përpara komisioneve funksionimin praktik të sistemeve mësimore interaktive, me qëllim që të verifikohet konkretisht në kohë reale çdo element përbërës, veçanërisht elementet që, për arsye të natyrës, nuk mund të paraqiten në formë të printuar.

d) Subjekti është i detyruar të bëjë, në tekstin e miratuar, korrigjimet e nevojshme të rekoman-

duara dhe e paraqet tekstin e ripunuar në MAS.

e) Tekstet shkollore digjitale (sistemet mësimore interaktive) të miratuara, të përfshihen në katalogun e teksteve shkollore digjitale.

IV. KONFLIKTI I INTERESIT

a) Punonjësit e MAS-it e të institucioneve të varësisë dhe anëtarët KVTD-së të mos jenë autorë teksti, botues apo pronarë shtypshkronje që merr pjesë në procesin e konkurrimit.

b) Autorët e teksteve shkollore të katalogut të teksteve shkollore të vitit në vazhdim, të mos jenë anëtarë të komisioneve të vlerësimit të teksteve digjitale.

V. SUBJEKTET KONKURRUESE

Subjektet pjesëmarrëse në konkurrim të paraqesin këto dokumente:

a) Dokumentin që vërteton se subjekti ka status aktiv dhe nuk është në proces falimentimi, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR).

b) Dokumentin që vërteton se subjekti i ka plotësuar detyrimet fiskale, lëshuar nga administrata tatimore.

c) Autorizimin e kompanisë së huaj për distributorin që ka të drejtën e shpërndarjes së sistemit interaktiv në Shqipëri.

d) Përmbajtjen digjitale të sistemit interaktiv online me të cilën konkurron, në format libri ose broshure (dosje) të printuar.

e) Materiale bazë për trajnimet e mësuesve dhe drejtuesve të shkollave që do të punojnë me këtë sistem interaktiv.

VI. POROSITJA DHE SHITJA E TEKSTEVE SHKOLLORE DIGJITALE

a) Përgjegjës për porositjen dhe shitjen e tekstit shkollor digjital janë subjektet e teksteve shkollore digjitale. DAR/ZA-të të monitorojnë porositjen dhe shitjen e tekstit shkollor digjital.

b) DAR/ZA-të dhe drejtoritë e shkollave t'u krijojnë kushte lehtësuese shpërndarësve të teksteve shkollore digjitale, njëkohësisht dhe t'i monitorojnë ata për zbatimin e procesit. Përgjegjësi i sektorit të IT dhe statistikës në DAR/ZA të jetë personi përgjegjës (pikë kontakti) që mban lidhje të vazhdueshme me KVTD-të në MAS dhe të informojë për mbarëvajtjen e procesit.

c) Shitja e tekstit shkollor digjital të bëhet në shkollë, dy javë përpara fillimit të vitit të ri shkollor dhe një javë pas këtij fillimi, sipas



procedurave të përcaktuara në legjislacionin tatimor në fuqi.

d) Ndaj subjekteve, botuesve ose distributorëve që nuk zbatojnë rregullin e mësipërm, të aplikohen masat sipas kuadrit ligjor në fuqi.

e) DAR/ZA-të, gjatë dy javëve para fillimit të vitit të ri shkollor dhe një javë pas tij, të raportojnë në MAS çdo ditë, në mënyrë të vazhdueshme, për porositjen dhe blerjen e teksteve shkollore digjitale.

VII. PARAQITJA E DOKUMENTACIONIT

Dokumentacioni për konkurrim të paraqitet në MAS, sipas afatit të përcaktuar në këtë udhëzim.

VIII. HYRJA NË FUQI DHE ZBATIMI

Ngarkohet Inspektorati Shtetëror i Arsimit për monitorimin e procesit të porositjes, shitjes dhe përdorimit të teksteve shkollore digjitale.

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm në MAS, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Teknologjisë, Komunikimit dhe Statistikave, Komisioni i Vlerësimit të Teksteve Digjitale, DAR/ZA-të dhe shkollat.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE I SPORTIT
Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 21, datë 26.6.2015

PËR VLERËSIMIN E ÇMIMEVE TË TEKSTEVE TË REJA DHE ÇMIMEVE TË TEKSTEVE DIGJITALE, NË SISTEMIN E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 47 pika 4 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Çmimet e të gjithë teksteve të reja, të cilat do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për vitin shkollor 2015-2016, do të propozohen nga subjektet dhe

vlerësohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, sipas metodologjisë së mëposhtme:

a) Çmimet e teksteve do të dorëzohen nga subjektet në MAS, në zarf të mbyllur, paralelisht me dorëzimin e teksteve të printuara apo digjitale, sipas udhëzimeve përkatëse dhe do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit.

b) Pas përfundimit të afatit të dorëzimit dhe vlerësimit të teksteve, komisioni i posaçëm i ngritur në MAS, në prezencë të shtëpive botuese apo subjekteve, bën hapjen dhe leximin e çmimeve të propozuara për tekstet nga subjektet dhe një kopje të procesverbalit të hapjes e vë në dispozicion të palëve pjesëmarrëse në proces.

c) Pas përfundimit të procesit të vlerësimit dhe renditjes së teksteve, për tekstet që rezultojnë fituese, MAS bën përllogaritjen dhe vlerësimin e çmimit mesatar aritmetik ose çmimit tavan të teksteve të miratuara.

d) Çmimi mesatar aritmetik ose çmimi tavan përllogaritet si shumatore e çmimit të teksteve fituese për një tekst të caktuar pjesëtuar me numrin e teksteve fitues. Ky çmim tavan do të aplikohet për ato tekste, për të cilat çmimi i propozuar nga subjekti e tejkalon çmimin tavan, ndërsa për tekstet e ofruar me çmim poshtë çmimit tavan, tekstet, pasi të vlerësohen nga MAS, do të shiten me çmimin e ofruar nga subjekti.

e) Nëse çmimi tavan i përllogaritur nga MAS sipas gërmes “d” të këtij udhëzimi ose çmimet e propozuara poshtë çmimit tavan nga subjektet, për tekstet e vlerësuara, tejkalojnë marxhin 10% mbi çmimin më të lartë të tekstit analog/të njëjtë tekst të aplikuar në vitin e mëparshëm, MAS i kërkon subjektit analizë të detajuar të çmimit dhe vlerëson çmimin e propozuar nga subjekti, por çmimi përfundimtar nuk duhet të tejkalojë marxhin maksimal prej 10% mbi çmimin e tekstit analog i aplikuar në vitin e mëparshëm.

f) Për vlerësimin e çmimit të teksteve digjitale (sistemeve mësimore interaktive), do të operohet me të njëjtën procedurë si më sipër, por për këto tekste, kufiri maksimal nuk duhet të tejkalojë marxhin prej 15% mbi çmimin e tekstit analog në formatin *hard-copy*.

Shembull i përllogaritjes së çmimit të teksteve shkollore të reja:
Matematika klasa parë (*hard-copy*)



Çmimi i propozuar nga subjekti	
Shtëpia botuese X	480 lekë
Shtëpia botuese Y	520 lekë
Shtëpia botuese Z	475 lekë

Çmimi tavan për tre tekstet e vlerësuara më sipër, i përlogaritur nga MAS është 492 lekë.

Shtëpitë botuese X dhe Z, të cilat kanë propozuar çmimin poshtë çmimit tavan, pas vlerësimit nga MAS, do të shesin tekstet me çmimin e propozuar (respektivisht 480 lekë dhe 475 lekë) ndërsa shtëpia botuese Y, e cila ka ofruar çmim mbi çmimin tavan, do të duhet të ulë çmimin e ofruar, në nivelin jo më shumë se çmimi tavan, pra jo më shumë se 492 lekë.

Por, referuar kufizimit të vendosur në pikat “e” dhe “f” të këtij udhëzimi, nëse çmimi më i lartë i tekstit të matematikës nga tekstet që kanë qarkulluar vitin e mëparshëm ka qenë 460 lekë, çmimi i vlerësuar dhe pranuar nga MAS, nuk mund të jetë më shumë se 506 lekë (460 lekë * marxhi maksimal 10%), për tekstet e printuara dhe jo më shumë se 529 lekë (460* marxhi maksimal 15%), për tekstet digjitale, vetëm në ato raste kur çmimet e ofruara nga subjekti apo çmimi tavan i përlogaritur nga MAS tejkalon këtë kufi. Në të gjitha rastet, kur çmimet rezultojnë poshtë këtij kufiri, do të procedohet sipas përcaktimeve, të dhëna në pikat “e” dhe “f” të këtij udhëzimi si dhe shembullin ilustrues.

2. Për tekstet të cilat hyjnë në qarkullim për herë të parë dhe nuk ka tekste analoge që mund të përdoren si referencë nga viti i mëparshëm, vlerësimi i çmimit do të bëhet nga MAS, bazuar në çmimin mesatar aritmetik/çmimin tavan, sipas mënyrës së përlogaritjes të përcaktuar në pikën “d” të këtij udhëzimi, pra në këtë rast nuk mund të aplikohet kufizimi i vendosur në pikat “e” dhe “f”, lidhur me kufirin e marxhit maksimal.

3. Nëse në përfundim të procesit të vlerësimit rezultojnë më pak se dy tekste të kualifikuar, çmimi i tekstit do të vendoset nga subjekti dhe MAS do të përlogarisë çmimin, duke mbajtur në konsideratë se çmimi i propozuar nga subjekti nuk duhet të kalojë kufirin maksimal prej 5% mbi çmimin më të lartë të tekstit analog për tekstet e printuara dhe 10% për tekstet digjitale.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Teknologjisë Infor-

macionit dhe Komunikimit, Drejtoria e Financës dhe komisionet e vlerësimit të teksteve.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE I SPORTIT
Lindita Nikolla

UDHËZIM I PËRBASHKËT Nr. 21, datë 9.7.2015

PËR PROCEDURAT E TRANSFERIMIT TË NXËNËSVE NGA NJË NIVEL/DREJTIM I ARSIMIT PROFESIONAL NË GJIMNAZ

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 12 pika 2, të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJMË:

1. Transferimi i studimeve nga arsimi profesional në gjimnaz mund të bëhet vetëm për nxënësit që kanë përfunduar klasën e 10-të në shkollat profesionale me kohë të plotë.

2. Nxënësit që kërkojnë të transferojnë studimet nga arsimi profesional në gjimnaz, duhet të plotësojnë kriterin e moshës të përcaktuar në nenin 23, pika 2, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

3. Për të realizuar transferimin, nxënësit duhet të plotësojnë lëndët e detyruara në planin mësimor të gjimnazit duke dhënë provime të veçanta për lëndët e munguara dhe një provim të integruar për pjesët/orët e munguara të lëndëve të përbashkëta.

4. Vendimi për numrin e lëndëve të munguara dhe provimin e integruar merret nga drejtoria e shkollës dhe ruhet e trajtohet si pjesë e dokumentacionit shkollor.

5. Procedurat e transferimit nga arsimi profesional në gjimnaz, përfshirë dhe dhënien e provimeve për lëndët/pjesët e munguara, fillon në përfundim të vitit shkollor dhe duhet të përfundojë para fillimit të vitit të ri shkollor.



6. Transferimi i nxënësit nga një shkollë e mesme profesionale në gjimnaz, bëhet me kërkesë të prindërve ose kujdestarit ligjor të nxënësit;

7. Procedura e realizuar në shkollë për transferimin e nxënësit nga arsimit profesional në gjimnaz, duhet të paraqitet për miratim në njësinë arsimore vendore përkatëse.

8. Drejtoritë e shkollës pritëse dhe shkollës nga transferohet nxënësi, pasqyrojnë shënimet përkatëse në amzë.

9. Nxënësit shqiptarë dhe të huaj, të cilët transferojnë studimet në shkollat profesionale nga jashtë shtetit në Shqipëri, duhet të japin provime për lëndët/praktikat profesionale të munguara.

10. Nxënësit shqiptarë ose të huaj, të cilët transferojnë studimet nga shkollat profesionale jashtë shtetit në Shqipëri, për vitet e ndërmjetme, bëjnë njehsimin e studimeve të kryera. Procedura e njëvlershmërisë së studimeve në këtë rast bëhet në Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, në bazë të dokumentacionit origjinal të përkthyer dhe noterizuar.

11. Nxënësit që duan të transferojnë studimet e kryera në arsimin profesional jashtë shtetit, në gjimnaz, duhet të plotësojnë kriteret e transferimit të përshkruara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij udhëzimi.

12. Për nxënësit shqiptarë ose të huaj që kanë ndjekur studimet në një shkollë të mesme të përgjithshme jashtë shtetit dhe dëshirojnë të transferohen në shkollat profesionale në Shqipëri, ky transferim nuk mund të bëhet.

13. Dokumentacioni dhe vendimet e marra për procesin e transferimit ruhet në sekretarinë e shkollës dhe është objekt i inspektimit të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit.

14. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe drejtoritë arsimore rajonale e zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Blendi Klosi

MINISTRI I ARSIMIT DHE I SPORTIT
Lindita Nikolla

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 84 lekë